



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 188, datë 07.05.2021**

**PËR**

**LEHTËSIM TË NGARKESËS SË GJYQTARIT TË KOLEGJIT ZGJEDHOR  
GJYQËSOR, Z.{...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 174/a, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61 dhe 89, shkronja b) të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 23 dhe 25 pika 3, shkronja dh) të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenin 26 pika 1 shkronja c) të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 149, pika 2 të Kodit Zgjedhor, pas shqyrtimit të kërkesës së gjyqtarit {...}, protokolluar me aktin nr. 1662 prot, datë 19.04.2021, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Lehtësimin e ngarkesës së gjyqtarit të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor z. {...}, për shkak të thirrjes së tij në detyrë për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në lidhje me zgjedhjet e përgjithshme në Kuvendin e Shqipërisë, nëpërmjet :
  - pjesëmarrjes në masën 50 % në procedurat e ndarjes me short në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të çështjeve që do të regjistrohen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Efektet e masës lehtësuese të ngarkesës së gjyqtarit të parashikuara në pikën 1 fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me një kohëzgjatje 2/mujore.
3. Ngarkohet Kryetari dhe Kancelari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Njoftimin e këtij vendimi z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**